

# GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

## SEKSIONI I TRETË

### VENDIM

Kërkesa nr. 32893/16

Yli PINARI

kundër Shqipërisë

(shihni tabelën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 16 maj 2024 si Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *president*,

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit*,

duke pasur parasysh kërkesën më sipër të depozituar më 1 qershor 2016,

duke pasur parasysh deklaratat formale për pranimin e zgjidhjes miqësore të çështjes,

pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

#### FAKTE DHE PROCEDURA

Detajet e kërkesit jepen në tabelën bashkëngjitur.

Kërkuesi u përfaqësua nga z. M. Gjoçi, avokat i licencuar në Tiranë.

Qeverisë shqiptare ("Qeveria") iu komunikua ankimi i kërkesit sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës, në lidhje me të drejtën e tij për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe mungesën e paanshmërisë së gjyqtarit të asaj gjykate.

Gjykata mori deklaratat për zgjidhjen miqësore të nënshkruara nga palët, sipas të cilave kërkesi pranoi të hiqte dorë nga çdo pretendim tjetër kundër Shqipërisë, në lidhje me faktet që çuan në këtë kërkesë, me kushtin që Qeveria të merrte përsipër t'i paguante atij shumën e detajuar në tabelën bashkëngjitur. Kjo shumë do të konvertohet në monedhën e Shtetit të paditur me kursin e këmbimit të datës së pagesës dhe do të paguhet brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast të mospagimit të kësaj shume brenda periudhës së lartpërmendur tremujore, Qeveria merr përsipër të paguajë një kamatëvonesë të thjeshtë nga momenti i mbarimit të kësaj periudhe deri në momentin e shlyerjes, me një normë të barabartë me normën e huadhënies marxhinale të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje.

Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

#### LEGJISLACIONI

Gjykata mban parasysh zgjidhjen miqësore të arritur ndërmjet palëve. Ajo është e bindur që zgjidhja bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut të përcaktuara në Konventë dhe në Protokollin e saj dhe nuk gjen arsye për të justifikuar shqyrtimin e kërkesës në vazhdim.

Nisur nga sa më lart, është me vend që çështja të çregjistrohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

*vendos* të çregjistrojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve në përputhje me nenin 39 të Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 6 qershor 2024.

**Viktoriya Maradudina**  
ZËVENDËSKANCELARE NË DETYRË

**Peeter Roosma**  
PRESIDENT

## SHTOJCË

Kërkesa që paraqet ankimin sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës  
(e drejta për gjykatë të paanshme dhe e drejta për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuetit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së deklaratës së kërkuetit	Shuma e caktuar për dëm pasuror dhe jopasuror dhe kosto dhe shpenzime për kërkuetit (në euro) <sup>1</sup>
32893/16 01/06/2016	<b>Ylli Pinari</b> 1953	Gjoçi Mirgen Tiranë	2.4.2024	1.4.2024	5.600

---

<sup>1</sup> Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuetit.